

E nderuara Deputete znj. Hadergjonaj,  
I nderuar Zëvendësministër z. Gashi,  
E nderuara Drejtoreshë Ekzekutive e SHKÇAK znj. Bunjaku,  
I nderuar Kryetar i Këshillit të SHKÇAK z. Pllana,  
I nderuar Drejtor i ATK z. Imeri  
Të nderuar pjesëmarrës  
Zonja dhe zotërinj,

Duke qenë shumë i nderuar për ftesën dhe mirënjohës për organizimin nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve (SHKÇAK), më lejoni që fillimisht të ju uroj ditën e Pavarësisë, ditë kjo e sakrificës sublime të popullit tonë, duke kujtuar të gjithë që bën të mundur që sot të kremtojmë këtë ditë të shenjtë.

Spektori bankar i Kosovës, si komponent kryesor e sektorit financiar gjatë këtyre 10 viteve u shndërrua në njërin ndër burimet kryesore të financimit të ekonomisë së vendit, duke i rezistuar madje edhe rrethanave më të pafavorshme gjatë periudhës së krizës globale. Ku karakterizohet me rritje të aseteve, depozitave dhe kredive, në këtë rast përderisa në muajin shkurt 2008 vlera e përgjithshme e kredive bankare ishte 937 milionë euro, aktualisht vlera e tyre ka arritur në rreth 2.5 miliardë euro, gjë e cila flet për një rritje të konsiderueshme të shkallës së ndërmjetësimit financiar në vend. Pjesa dërmuese e këtyre kredive i janë lëshuar bizneseve, përderisa burimi kryesor i financimit të tyre janë depozitat e mbledhura nga ekonomitë familjare, gjë e cila flet për një kanalizim shumë të rëndësishëm të këtyre mjeteve nga kursyesit drejt investitorëve.

Kreditimi bankar, përveç se u karakterizua me rritje të qëndrueshme, në vazhdimësi regjistroi edhe përmirësim të kushteve të financimit për bizneset dhe ekonomitë familjare, duke e fuqizuar kështu edhe më tutje rolin e tij në financimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Me këtë rast, dëshiroj të potencoj rënie e theksuar të normave të interesit në kreditë bankare, të cilat tanimë kanë zbritur në nivelin e mesatares së rajonit, duke nxitur kështu kërkesën për kredi dhe duke mundësuar realizimin e shumë projekteve investive të cilat nuk do të mund të ndodhnin pa financimin bankar. Aktualisht, norma mesatare e interesit në kredi qëndron në 6.1 përqind, krahasuar me normën mesatare prej 14.3 përqind në kohën e shpalljes së pavarësisë së vendit.

Se Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në fushën e qasjes në financa, e konfirmon edhe Raporti i të Bërit Biznes i Bankës Botërore, ku kriteri i qasjes në financa e radhitë Kosovën në mesin e vendeve më të avancuara në botë.

Përveç kontributit në financimin e aktivitetit ekonomik, sektori bankar paraqet një shtyllë shumë të rëndësishëm edhe të stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik të vendit. Treguesit e shëndetit financiarë e radhitin Kosovën në mesin e vendeve me sektorët më të qëndrueshëm bankar. Me këtë rast do të përmend vetëm treguesin e kredive joperformuese prej 3.1 përqind, i cili mjafton për të treguar shëndetin shumë të mirë që gëzon sektori bankar i Kosovës.

Zhvillime të ngjashme pozitive kanë karakterizuar edhe komponentët e tjerë të sistemit financiar në Kosovë. Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare po fuqizon çdo ditë e më tepër rolin e tij në financimin e ekonomisë së vendit përmes mikrokredive. Sistemi pensional me sukses

po arrin të menaxhojë kursimet pensionale të qytetarëve të Kosovës, duke shtuar vlerën e këtyre kursimeve përmes politikave të kujdesshme të investimit të këtyre mjeteve në tregun vendor dhe në tregjet financiare ndërkombëtare. Në vitin 2017, sektori i sigurimeve shënoi fitim neto në vlerë prej rreth 7 milionë euro, që paraqet nivelin më të lartë të profitit të shënuar ndonjëherë nga ky sektor. Performanca pozitive ka mundësuar përmirësimin e treguesve kyç të shëndetit të këtij sektori, gjë që e bënë këtë sektor më të qëndrueshëm dhe më të aftë për të rritur rolin e tij në ekonominë e Kosovës, përveç kësaj çdo ditë e më tepër po e rrit aktivitetin në fushën e sigurimeve vullnetare të cilat janë shumë të rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut dhe rritjen e aktivitetit në ekonominë e vendit.

Standardizimi sot përbën një koncept të domosdoshëm në të gjitha fushat e jetës. Profesionit i kontabilitetit është një nga fushat ku kjo përbën një imperativ. Përmes angazhimit të vazhdueshëm dhe për një kohë të gjatë, SHKÇAK ka bërë një punë kolosale në këtë drejtim, përveç tjerash edhe përmes organizimit të kurseve për certifikim në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Ne si Bankë Qendrore e Republikës së Kosovës i kemi dhënë peshë të veçantë standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, gjë që është specifikuar edhe në Ligjin për Banka, IMF dhe IFJB. Për më shumë, bankave ju kërkohet që llogaritë dhe pasqyrat financiare t'i kenë në formë të detajuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Kjo, përveç tjerash bën të mundur edhe krahasimin e treguesve të caktuar financiarë me vendet e tjera. Në funksion të konvergencës dhe përcjelljes lidhur me zhvillimet e fundit me standardet ndërkombëtare, BQK-ja është në proces të **avancimit lidhur me standardin IFRS 9**, ku deri më tani janë bërë zhvillime domethënëse.

Duke qenë mirënjohës për vëmendjen tuaj, ju faleminderit dhe urime Dita e Pavarësisë!